
MATERIALE SHKENCORE E KUMTESA

MARENGLLEN VERLI

SHABAN POLLUZHA DHE REVOLTA E DRENICËS*

Shaban Polluzha spikat në konstelacionin e atdhetarëve të kombit shqiptar të të gjitha kohërave. Ai diti të orientohej drejt dhe të kishte si pikë referimi në rrugën e jetës së tij jo të shkurtër, rreth 75-vjeçare, aspiratat e kombit dhe, në finalen e veprimtarisë së tij, u sakrifikua pikërisht për to.

E dinte fundin që e priste kur ngriti armët për të kundërshtuar dhunën e një armate të fuqishme, por nuk hezitoi për asnjë çast të ecte drejt vetëflijimit në rrugën e detyrës e të nderit, që e çoi drejt lavdisë, duke u bërë simbol e burim frymëzimi për gjeneratat e reja. Kjo është rruga e burrave të mëdhenj. Dy dekada para vrasjes së tij, një burrë tjetër i shquar këtë herë nga Plavë-Gucia, Mulla Agan Plava, pak kohë para se ta likuidonin me atentat në bjeshkët e Tropojës, ku ishte strehuar pas ripushtimit të krahinës së tij në shkurt 1919 dhe masakrimin të banorëve të saj nga forcat ushtarake serbe e çetnikët malazezë, kur e pyetën me naivitet ose në mënyrë provokative, se ç'fituan ai dhe shokët e tij nga gjithë ajo luftë, nga gjithë ato sakrifica e gjak, kish ngritur supet me habi dhe qe përgjigjur thjesht: “Bëmë detyrën”.¹

Një amanet i madh, “Bëmë detyrën”.

Këtë bëri edhe Shaban Polluzha dhe atdhetarë të tjerë të shquar si Adem Gllavica, Hysen Tërpeza, Mulla Idriz Gjilani, Adem Voca etj., dhe mijëra (rreth 15 mijë) shqiptarë të Kosovës në dimrin e viteve 1944-1945.

Po përse erdhi ajo situatë e rëndë për shqiptarët e Kosovës, që çoi në atë shpërthim zemërimi masiv popullor? Ç'kishim humbur e pësuar ndër vite e çfarë aspironin shqiptarët? Çfarë u ishte premtuar dhe çfarë po

* Referat i mbajtur në Prishtinë, në Akademinë Solemne, më 21 shkurt 2020, organizuar me rastin e 75-vjetorit të Revoltës së Drenicës dhe të rënies së Shaban Polluzhës.

¹ Marenglen Verli, *101 Profile Biografike*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: 2015, f. 808.

ndodhte në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare në fund të Luftës së Dytë Botërore? Nëse do të bëhej një historik i shkurtër i 32 vjetëve, që kishin kaluar nga koha e copëtimit të trevave shqiptare me vendimin arbitrar të ambasadorëve të Fuqive të Mëdha të marrë në Konferencën e Londrës, rezulton se shqiptarët e Kosovës dhe trevave të tjera shqiptare veriore, verilindore e lindore, kishin përjetuar dhunën serbe për 25 vjet (vetëm 7 vjet ata kishin jetuar nën një sundim, pa krahasim, më të lehtë se sundimi serb).

Serbia e Mali i Zi në vitet 1912-1915 dhe shteti serbo-kroato-sllloven (SKS) ose Mbretëria Jugosllave më 1918-1941 si edhe çetnikët, po edhe partizanët e mareshalit Tito, në vitet e Luftës së Dytë Botërore ishin, me pak ndryshime në periudha të caktuara, regjime apo grupime politike e formacione ushtarake që hartuan e zbatuan projekte për asgjësimin e shqiptarëve dhe prodhuan dhunë e terror deri në gjenocid kundër tyre. Qarqet drejtuese të Beogradit në mënyrë permanente, përmes dhunës shumëformëshe, përmes shpronësimit dhe shpërnguljes së dhunshme e masive të shqiptarëve dhe kolonizimit sllav të viseve të tyre, patën si objektiv strategjik konstant ndryshimin e strukturës etnike të viseve shqiptare, përndryshe shkombëtarizimin dhe sllavizimin e tyre.

Në prag të Luftës së Dytë Botërore shqiptarë në Kosovë e më gjerë ishin keqtrajtuar, varfëruar ekonomikisht dhe reduktuar ndjeshëm në aspektin demografik. Duke filluar nga Lufta e Parë Ballkanike e vitit 1912-1913, ata ishin përgjysmuar numerikisht dhe për gati 3 dekada (29 vjet) nuk patën shans të rikuperonin pothuajse asgjë. Nga, mbi 1 milion shqiptarët e vitit 1912, që jetonin në trevat e aneksuara nga Serbia e Mali i Zi me vendimet e Konferencës së Londrës më 1913, në fillim të viteve 20-të kishin mbetur më pak se 0,5 milion (441.000 shqipfolës nga të cilët 351.000 në territorin e Kosovës së sotme) dhe në vitet 40-të, në regjistrimin e parë të Jugosllavisë Federative, numri do të sillej rreth 750 mijë, kur duhet, që në kushte normale të rritjes demografike, popullsia shqiptare të kapte shifrën e 2 milion banorëve.² Klima e acartë e pandërprerë antishqiptare e kishte zbrazur Kosovën për disa qindra mijë

² Justin McCarthy, *Vdekje dhe dëbim. Spastrim etnik i myslimanëve osmanë (1821-1922)*, Tiranë: ALSAR, 2017, f. 149, 157-158, 171; *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. III (1925-1939), Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2020, f. 597.

banorë, i kishte hequr popullsisë vitale autoktone të saj pronësinë për rreth 200 mijë hektarë tokë, vetëm në këtë trevë, përmes taksave speciale e grabitjes së llojlojshme u kish rrënuar bizneset shumë zejtarëve e tregtarëve, duke i kthyer shumë qytete të Kosovës për dhjetëra vjet në hije të pamjes së tyre ekonomike, demografike e urbanistike të dikurshme.³

Rezistenca e popullsisë shqiptare në të gjitha format, madje edhe qëndresa me armë për gati 10 vjet pas Luftës së Parë Botërore, e kishin frenuar, por nuk kishin mundur ta ndalnin zbatimin e politikës antishqiptare të Beogradit dhe pasojat e saj. Në këtë qëndresë kishte spikatur Drenica, vatra tradicionale shekullore e qëndresës kundër pushtuesve dhe pushteteve të ndryshëm të huaj të ngritur me dhunë.

Në këtë qëndresë ishte aktivizuar qysh herët edhe Shaban Polluzha, një nga burrat e fortë të Drenicës. Për veprimtarinë e tij të hershme nuk ka fort të dhëna të dokumentuara, por dihet që familja e tij kish qenë aktive në kryengritjet e mëdha kundër sundimit osman. Në vitet 1916-1918, Sh.Polluzha iu kundërvu pushtimit bullgar duke reaguar hapur në takimet me autoritetet bullgare ndaj plaçkitjeve dhe keqtrajttimeve që bënin ushtarët bullgarë në fshatrat e Drenicës dhe për këtë ai u arrestua. Më pas, në vitet e MSKS, ai rezultoi të ketë qenë përkrahës i çetave kaçake, të cilat në vitet 20, me një program të qartë kombëtar e çlirimtar, orientoheshin nga Komiteti “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës” (KMKK) dhe ideologët e shquar që e drejtonin atë si Hoxha Kadriu, Hasan Prishtina, Bedri Pejani, Sali Nivica etj., dhe që në terren u prinin nga të mirënjohurit Azem Bejtë Galica, Sadik Ramë Gjyrgjeviku, Zef Gjiododa, Mehmet Konjuhi etj.

Shqiptarët humbën jo vetëm numerikisht e materialisht në vitet 1912-1941. Ata përgjithësisht humbën besimin se mund të bashkëpunohej me serbët për ndërtimin e një bashkëjetese normale. Një propagandë e shfrenuar shoviniste që drejtohej nga politika dhe administrata zyrtare, nga media dhe kleri serb, e që konkretizohej nga veprimet e autoriteteve shtetërore civile e ushtarake të të gjitha niveleve, e deri nga individë të shumtë të komunitetit serb vendas, ose kolonët e sjellë posaçërisht, e kishte thelluar hendekun midis kombeve. Konventa

³ Marenglen Verli, *Kosova, sfida shqiptare në historinë e një shekulli*, Tiranë: Botimpex, 2007, f. 159-167.

jugosllavo-turke e vitit 1938, për shpërnguljen e 40 mijë familjeve shqiptare, 11 projektet e “Klubit serb të Kulturës” në vitet 30-të ndër të cilët ai i Vasa Çubrilloviqit famëkeq, projektet e nëpunësve shtetërorë Ivo Andriq e Ivan Vukotiq, që synonin edhe territore të Shqipërisë Londineze, elaboratet genocidale të çetnikëve Stevan Mokviqit e Drazha Mihajloviqit pas prillit të vitit 1941, ishin dëshmi e frymës permanente antishqiptare.⁴ Edhe ndonjë prononcim pozitiv ndaj shqiptarëve, që ishte shfaqur nga socialdemokracia serbe në vitet e Luftërave Ballkanike e Botërore (Dimitrie Tucoviq) apo nga PK Jugosllave më pas, nga fundi i viteve 30, përgjithësisht nuk e kish kapërcyer nivelin e kritikave ndaj pushtetit të kohës dhe të kërkesave për respektimin e shqiptarëve si një minoritet brenda Serbisë ose Jugosllavisë. Në ndonjë rast u fol për formimin në të ardhmen e një njësie me statusin e një republike në një shtet federal jugosllav, por aspiratat e shqiptarëve për t’u kthyer në gjirin e shtetit kombëtar, pothuajse kurrë nuk u përmendën, përveçse për demagogji dhe të shoqëruar me justifikim kundërshtues.

Gjithsesi, në vitet e Luftës së Dytë Botërore, PKJ që drejtonte Luftën Antifashiste në Jugosllavi për interesa politike strategjike i trajtoi fillimisht shqiptarët njëlloj si kombet dhe popujt e tjerë të atij vendi. Ky trajtim zuri fill nga Konferenca V e Vendit e PKJ që u mbajt në Zagreb më 19-23 tetor të vitit 1940. Në atë konferencë Moshë Pijade, një nga udhëheqësit kryesorë të PKJ, në referatin që mbajti për çështjen kombëtare, theksoi se “zgjidhja e çështjes kombëtare edhe këtu [në Kosovë] mund të arrihet me formimin e Republikës së lirë punëtore-fshatare të Kosovës”.⁵

Në përputhje me këto qëndrime në Konferencë u pranua propozimi për ta shkëputur varësinë e Komitetit Krahinor për Kosovën nga Komiteti Provincial për Malin e Zi, Bokën dhe Sanxhakun, për ta lidhur atë drejtpërdrejt me KQ të PKJ. Ky status vijoi gjatë gjithë viteve të luftës. Rëndësi për trajtimin e problemit kombëtar në Kosovë pati edhe formimi i Shtabit Kryesor të UNÇL për Kosovën, me të njëjtat funksione si shtabet kryesore të popujve të tjerë të Jugosllavisë. Vendimet e këtij Shtabi për përdorim të barabartë të flamujve dhe gjuhëve nga popullsia dhe repartet partizane ishin dukuri që jepnin shpresë për trajtimin e

⁴ *Po aty*, f. 183, 270, 284.

⁵ M. Piade, *Mbi ngritjet në Kosovë*, Tiranë: 1981, f. 85.

barabartë të shqiptarëve me popujt e tjerë të Jugosllavisë nga forca politike që drejtonte Luftën Antifashiste atje.

Duke marrë shpresë nga fryma pozitive që vërehej, Konferenca e Bujanit më 31 dhjetor 1943 - 2 janar 1944, që krijoi Këshillin NÇ për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit, mori vendime ku flitej për aspiratën e shqiptarëve për t'u bashkuar me Shqipërinë dhe të drejtën e tyre për vetëvendosje pas luftës. Vendimet e Konferencës i çonin më tej arritjet e deriatëhershme, por ky qe kulmi, sepse do të pasonte kthesa me letrën e 28 marsit 1945 të S.Gjilasis, që hidhte poshtë vendimet e Konferencës në emër të KQ të PKJ (mbështetur në vendimet e Mbledhjes së Dytë të Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar (KANÇ) (29-30.XI.43).⁶

Gjatë vitit 1944, Partia Komuniste Jugosllave (PKJ) nuk u prononcua hapur çdo të bëhej me Kosovën pas luftës, dhe qëndrimet e J.Titos, E.Kardelit dhe V.Bakariçit shkonin më tepër që ajo të bëhej një provincë autonome dhe jo pjesë e Serbisë së Re Federative (takimi në ishullin e Visit në verë 1944). Por, më 2 shtator 1944, Shtabi Suprem i Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave (UNÇJ) vendosi ta shndërronte Shtabin Kryesor të Kosovës dhe Metohisë në Shtab Operativ dhe pas 14 shtatorit e vuri atë nën vartësinë e Shtabit Kryesor të UNÇJ për Serbinë. Ky nuk ishte për shqiptarët një ogur i mirë, aq më tepër se ky shtab në gushtin e vitit 1944, në një proklamata drejtuar popujve të Kosovës i fyente shqiptarët, madje i kërcënonte kur shprehej se “ju deri tani keni qenë të mashtruar prej gjermanëve dhe i keni ndihmuar ... Për shkak të qëndrimit tuaj ju deri tani nuk e keni fituar të drejtën të jetoni në barazi e vëllazërim me popujt e tjerë të Jugosllavisë”.⁷ Fantazmat e të kaluarës po rishfaqeshin. Në duart e udhëheqësve të lartë të PKJ, ekstremistë si V.Çubrilloviqi po guxonin të paraqisnin elaborate që planifikonin asgjësimin e shqiptarëve duke përfutur nga situata e luftës.

Në nëntor 1944 në gazetën “Liria”, Pavle Joviçeviçi pa trajtuar çështjen e statusit të Kosovës pas LDB, shprehej se shqiptarëve në Jugosllavi do t'u garantoheshin të drejtat si “pakistanale”. Ndonëse edhe deri në këtë kohë statusi i Kosovës pas luftës nuk u përcaktua qartë

⁶ Lefter Nasi, *Ripushtimi i Kosovës (shtator 1944-shtator 1945)*, Tiranë: 1994, f. 75, 111.

⁷ *Zbornik dokumenata i podataka o narodno oslobodilačkom ratu Jugoslovenskih naroda*, tom. I, knj 19, Borba na Kosovu 1941-1944, Beograd: 1969, dok. 144.

e hapur, shqetësimet e shqiptarëve erdhën duke u rritur (do të dilte se në elitën e PKJ ishte finalizuar ideja që Kosova të ishte pjesë e Republikës Federative të Serbisë.

Në dhjetor 1944 në Mbledhjen e Frontit Unik Nacionalçlirimtar të Serbisë që u mbajt në Beograd, Sreten Zhujoviq deklaroi se "... Kosova është e jona dhe s'ka kurrfarë diskutimesh për këtë. Po qe se Shqipëria organizohet në principe të njëjta si edhe ne, s'do të kishim asgjë kundër që arnautët tanë të shkëputen dhe t'i bashkohen asaj".⁸

Në fundin e janarit 1945, udhëheqësit e PKJ-së, të përfaqësuar nga Aleksandër Rankoviçi, Millovan Gjillasi dhe Svetozar Vukmanoviç Tempo thirrën në Beograd, Miladin Popoviçin dhe Fadil Hoxhën për një konsultë dhe u bënë të ditur vendimin se, Kosova do të kishte autonomi formale dhe do t'i bashkëngjitej Serbisë, se do të mbahej vetëm flamuri i Jugosllavisë dhe Serbisë, kurse flamuri shqiptar nuk duhej të dukej më.⁹

Në mbledhjen e KQ të PKJ që u mbajt në Beograd më 18 shkurt 1945, ku morën pjesë edhe Miladin Popoviçi e Fadil Hoxha u vendos që Kosova do t'i aneksohej Serbisë. Vetëm për fasadë pati diskutime dhe u dhanë argumente demografike, politike, ekonomike pse Kosova duhej t'i aneksohej Serbisë, me ç'rast E.Kardeli, duke përjashtuar çdo ide për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, u shpreh: "Më e natyrshme do të ishte që Kosova e Metohija t'i bashkohen Shqipërisë. Mirëpo meqë raportet e forcave në Shqipëri nuk janë dominuar akoma nga Lëvizja NÇI si në Jugosllavi dhe situata në Ballkan është e komplikuar ... tani për tani nuk vjen në konsideratë që Kosova e Metohija t'i bashkohen Shqipërisë".¹⁰ Nuk mund të thuhet me siguri deri në ç'nivele ishte e njohur metamorfoza në qëndrimet e PKJ që në thelb synonte të ruante, madje t'i zgjeronte pas luftës kufijtë e Jugosllavisë, por një qëndrim më agresiv e arrogant i formacioneve të UNÇL Jugosllave, ndërkohë që gjermanët në nëntor e lanë Kosovën, ishte i dukshëm.

Përballë politikës zyrtare të Beogradit, Sh. Polluzha ishte shfaqur në vitet 20-30 përkrah popullit të tij, jo vetëm si përkrahës i lëvizjes së

⁸ *Borba*, 8 prill 1945, f. 2.

⁹ Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës (1939-1981)*, Instituti i Historisë-Prishtinë: 2017, f. 104.

¹⁰ Xhaferr Shatri, *Vështrim i përgjithshëm mbi politikën serbomadhe në Kosovë*, Geneve: Mërgimtarët nga Kosova, 1987; M. Mitkoviç, "Kosmet moje mladost", në *Nin*, 16 gusht 1987, f. 57.

rezistencës me armë, por edhe si burrë i besës, burrë kuvendi e pajtues gjaqesh. Duke fituar vendin e kryetarit të komunës së Vërbovcit, pas Luftës së Parë Botërore dhe krijimit të MSKS, ai kishte shfrytëzuar çdo mundësi për të mbrojtur bashkëkombësit e tij për t'ua lehtësuar atyre sa të ishte e mundur jetën e vështirë nën sundimin e Jugosllavisë.

Në vitet e Luftës së Dytë Botërore, në moshën tashmë rreth 75-vjeçare (1871-1945), Sh. Polluzha kishte përvojën dhe pjekurinë për të kuptuar pozicionin tragjik të shqiptarëve në Kosovë e më gjerë, dhe, edhe pse skeptik për një bashkëpunim të sigurtë me serbët, u pozicionua për përkrahjen e lëvizjes antifashiste, si alternativa e vetme realiste që garantonte perspektivën. Pa hezitur t'u dilte përballë me armë çetnikëve, që sulmonin viset shqiptare, në krye të forcave popullore të vetëmbrojtjes, ai mbështeti lëvizjen antifashiste, ndoshta duke shpresuar në qëndrimin e deklaruar të PKJ, ndoshta edhe duke u besuar veçanërisht përfaqësuesve shqiptarë të saj, por edhe pse e kuptonte dhe e konsideronte alternativë shkatërruese përkrahjen e pushtuesve nazifashistë. Madje, për veprimtarinë e tij antifashiste Sh. Polluzha ishte arrestuar dhe burgosur në Pejë bashkë me familjen. Në fillim të vitit 1943, në krye të një aradhe të forcave vullnetarësh, Sh. Polluzha ishte angazhuar në veprime vetëmbrojtëse në pjesën perëndimore të Kosovës kundër forcave terroriste çetnike. Masakra e Bihorit, kishte shërbyer jo vetëm për të evidentuar pa dilema se çfarë mund të bënin çetnikët serbë e malazezë, por kishte kompromentuar plotësisht edhe qëndrimin e pushtuesve fashistë italianë, që, më e pakta, ishin të interesuar për konflikte ndërnacionale në rajon për të larguar presionin ndaj tyre, i cili mund të rritej në kushtet e një mirëkuptimi e bashkëpunimi midis forcave antifashiste. E njëjta gjë mund të thuhet për qëndrimin e gjermanëve në trevën e Novipazarit.¹¹

Gjithsesi situata ishte tejet e komplikuar. Faktori ndërkombëtar perëndimor, por edhe PKJ, shpreheshin në mënyrë evazive për të ardhmen e shqiptarëve, për vlerësimin e aspiratave të tyre. Natyrisht, Fuqitë Perëndimore e njihnin mirë historinë e Ballkanit, të ndërthurjes së interesave nacionale rajonale dhe u duhej të ndiqnin një politikë që të përfitonin sa më shumë pasues në luftën kundër Bllokut Fashist, të

¹¹ L. Nasi, *Ripushtimi i Kosovës ...*, f. 9, 15.

shmangnin qëndrimet që prodhonin armiq, dhe të neutralizonin, sa të ishte e mundur, këdo që nuk mund të bëhej mik e aleat.

Në këtë situatë, kur flitej për “vetëvendosje” pas luftës për ata që do të “kontribuonin në luftën kundër fashizmit”, Sh. Polluzha pati busull orientimi interesat e popullit të vet. Në vitin 1943 ai pranoi detyrën e kryetarit të komunës së Skënderajt, nga Këshilli i Naltë i Qeverisë së Përkohshme, bashkëpunoi me parinë e vendit për të shmangur aksionet çetnike në viset perëndimore e veriore të Kosovës e më gjerë, dhe më 20 nëntor 1944, organizoi Kuvendin e Drenicës me 200 pjesëmarrës, i cili vendosi për mobilizimin e të rinjve në radhët e formacioneve brigadës partizane, mbështetur në frymën e Rezolutës së Bujanit.

Në këtë kohë, Sh. Polluzha praktikisht ishte prijësi i parë i forcave popullore të Drenicës, që gjetën motivim dhe u angazhuan për zbatimin e Rezolutës së Konferencës së Bujanit edhe pse në muajt e fundit të vitit 1944, rrjedha e ngjarjeve nuk dukej pozitive. Shtabi Kryesor i UNÇ ishte kthyer në nivelin e Shtabit Operativ më 2 shtator dhe më 14 shtator që vënë nën vartësinë e Shtabit kryesor të UNÇL për Serbinë*.

* Këshilli Nacionalçlirimtar për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit (31.12.1943 – 2.01.1944) ishte themeluar në një konferencë në Bujan me pjesëmarrje politike e nacionale pluraliste (nga 49 delegatë që morën pjesë, 43 ishin shqiptarë, 4 serbë, 3 malazezë, 1 mysliman. Pjesëmarrësit në shumicën e tyre ishin komunistë, por nuk mungonin nacionalistët, atdhetarët demokratë, përfaqësuesit e njërive të armatosura, të rinisë e të gruas antifashiste, të këshillave nacionalçlirimtare në një konferencë ku ishte pjesëmarrës edhe një përfaqësues i misionit britanik, Sh. Polluzha kishte parë garanci të mjaftueshme se e ardhmja e shqiptarëve ishte disi e siguruar. Rezoluta, e hartuar dhe e firmosur nga burra me emër e prestigj të padiskutueshëm si Mehmet Hoxha, Zekeria Rexha, Hajdar Dushi, Xheladin Hana, Fadil Hoxha etj., si edhe prej përfaqësuesve serbë e malazezë, ku përveç deklaratave për forcimin e vëllazërimit të popujve, për bashkimin e gjithë patriotëve të ndershëm pa dallim feje, kombësie e tendence politike, në luftën e armatosur kundër pushtuesve fashistë, shpallte strukturën kombëtare të popullsisë në atë trevë si territor i banuar me shumicë shqiptare, gjithashtu aspiratën e tyre për bashkim me Shqipërinë, si edhe domosdoshmërinë e luftës për realizimin pas saj të parimit universal të së drejtës së popujve për vetëvendosje deri në shkëputje, në përputhje të plotë kjo me Kartën e Atlantikut dhe me deklaratat për të drejtën e vetëvendosjes, që kishin bërë qysh në fillim të luftës vetë udhëheqësit komunistë jugosllavë, ishte, në mos shkak për entuziazëm (për shkak të së kaluarës së hidhur në marrëdhëniet shqiptaro-serbe), së paku arsye për qetësi, besim dhe madje, motiv përcaktimi për rrugën që duhej ndjekur. Në fund të fundit,

Por, në gjysmën e dytë të vitit 1944 dhe gjatë dimrit të viteve 1944-45, Sh. Polluzhës do t'i duhej të orientohej në zgjidhjen e një ekuacioni me shumë të panjohura. Në rrethanat e krijuara, kur vihej re një ndryshim aspak pozitiv në qëndrimet e PKJ, kur për shqiptarët, së pari rrezikohej jeta nga formacione çetnike, ai iu bashkua nismës së disa krerëve të Drenicës, ndër ta edhe kundërshtarë të komunistëve, për të organizuar nën drejtimin e një shtabi të përgjithshëm, forca të vetëmbrojtjes, që kishin për ideal bashkimin kombëtar. I zgjedhur kryetar i forcave vendore vullnetare ai, në mes të dhjetorit 1944, kishte grupuar rreth vetes gati 1000 luftëtarë.¹²

Situata që shpërthyes. Në Ferizaj më 2-3 dhjetor e pastaj në Gjilan në dhjetëditëshin e fundit të dhjetorit, revoltat e fuqishme shqiptare të disa mijë fshatarëve e qytetarëve shqiptarëve të atyre viseve të drejtuara nga Hysen Terpeza, Mulla Idriz Gjilani etj., që nuk pajtoheshin me ndalimin e përdorimit të flamurit shqiptar dhe terrorin e reparteve ndëshkimore, po mbyteshin në gjak. Dukej sikur terrori e persekutimet ishin të programuara për të nxitur revolta e me pretekstin e tyre të masakrohej popullsia shqiptare masivisht.¹³

Në janar 1945 u formua Brigada VII e Kosovë-Metohisë e UNÇL. Pas formimit të saj, formacionet e komanduara nga Sh. Polluzha, që përbënin aradhën e Drenicës me një efektiv prej rreth 1000 luftëtarësh, me urdhër të Shtabit Operativ të Kosovës, më 17 janar 1945, u rreshtuan në këtë njësit dhe ai u caktua zëvendëskomandant. Duke vlerësuar drejt hapin që duhej bërë, Sh. Polluzha pas dy takimeve të sforcuara me Fadil Hoxhën në Mitrovicë dhe Skënderaj, pasi mori garancinë se nuk do të kishte më dhunë nga formacionet e UNÇLJ dhe forcat e tij nuk do të shpërndaheshin nëpër brigadat e saj, pranoi që aradha që e komandonte ai të nisej për në Frontin e Sremit në veri të Jugosllavisë ku luftohej kundër gjermanëve në përbërje të Brigadës VII kosovare.¹⁴

Por, udhëheqja jugosllave me këtë rast kishte planifikuar asgjësimin e kësaj njësie, rritjen e së cilës me të rinj shqiptarë e shikonte me shqetësim. Prandaj marshimin e saj jashtë Kosovës nuk desh ta

alternativë tjetër nuk kishte. (Dihet se më 28 mars 1944, KQ i PKJ, me një letër të M. Gjilasit, kundërshtoi vendimet e K. Bujanit).

¹² L. Nasi, *Ripushtimi i Kosovës ...*, f. 153.

¹³ *Po aty*, f. 144-150.

¹⁴ *Po aty*, f. 52-54.

lejonte të bëhej si një formacion kompakt, por të ndarë në kolona, që duhej të niseshin në kohë të ndryshme, dhe nën kontrollin e formacioneve ushtarake serbe. Ndërkohë, lajmi mbi terrorin dhe dhunën që po vazhdonte të ushtrohej në Drenicë dhe në rajone të tjera të Kosovës mbi popullsinë civile nga repartet jugosllave, shkaktoi revoltë në efektivat e Brigadës VII të bashkuar. Sh. Polluzha i paraqiti protestë Shtabit Operativ të Kosovës kundër kësaj veprimtarie antishqiptare dhe kundërshtoi urdhrin për të marshuar në veri. Për këtë shkak, Shtabi Operativ i Kosovës dhe Shtabi i Divizionit 26 serb natën e 23-24 janarit 1945 urdhëruan bllokimin në fushën e Podujevës dhe asgjësimin e forcave të Sh. Polluzhës. Duke pasur në dispozicion forca të shumta ushtarake Shtabi Operativ i Kosovës vendosi të ndërmernte ofensivën për asgjësimin e luftëtarëve shqiptarë që kishin ngritur krye kundër hyrjes së dhunshme të forcave serbe në zonat e tyre.

Pas luftimeve të ashpra Llap e Sitnicë, aradha e Drenicës e Sh.Polluzhës, me 3-400 luftëtarë, çau rrethimin, kapërceu rrugën Prishtinë-Mitrovicë, dhe e shtuar rrugës me rreth 6 000 luftëtarë.¹⁵ depërtoi në Drenicë, në fshatrat Verbovc, Tërsenik, Polluzhë, Obri, Makermal, Rezalle, Ticë etj.

Në veprime efikase dhe me përkrahjen e popullit kryengritës, u arritën suksese të dukshme, çka i shtoi më tej radhët e luftëtarëve me burra të shumtë të trevës. Repartet e Aradhës së Drenicës u përpoqën t'i shmangeshin luftimeve me njësitë kosovare të përbëra nga të rinj shqiptarë, sidomos me forcat e Brigadës IV dhe Batalionit IV të saj të përbërë vetëm me shqiptarë. Ndërsa përleshjet me repartet serbo-malazeze ishin jashtëzakonisht të ashpra.¹⁶

Shqiptarët e Sh.Polluzhës kishin arsye të luftonin fort. Brenda dy-tre muajsh gjendja në Kosovë kishte agravuar në mënyrë të paimagjinueshme. Me largimin e trupave gjermane kishin ndodhur ndryshime politike. Kosova dhe viset e tjera, deri në këtë periudhë të bashkuara me Shqipërinë (pavarësisht nga planet e pushtuesve) tani kishin kaluar nën administratën jugosllave. Projektet e hartuara nga PKJ

¹⁵ Ali Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë 1941-1945*, Prishtinë: 1971, f. 420; M. Shaqiri, "Më kujtohet" *Rilindja*, 20 dhjetor 1981, f. 14.

¹⁶ Spasoje Gjakoviq, *Sukobi na Kosovu*, Belgrade: 1984; A. Urosheviq, *Kosovo*, Beograde: 1965, f. 248.

dhe fushata e egër e terrorit që zbatuan formacionet ushtarake jugosllave që në dhjetor 1944 kishin rritur pakënaqësitë dhe kishin provokuar kundërshtimin e vendosur dhe revoltat e ligjshme të shqiptarëve. Reparte partizane, në radhët e të cilave kishin gjetur strehë edhe shumë çetnikë, që kishin ndërruar flamur në momentet e fundit, po masakronin masivisht popullsinë civile shqiptare, pa kursyer gra, fëmijë e pleq. “Partizanët serbë e malazezë, theksohej se, në një raport të kohës, që relatohej nga seksioni politik i Divizionit V të UNÇSH për KQ të PKSH (23 mars 1945), kanë vrrarë popull pa kriter ... vrasjet dhe pushkatimet janë kryer kaq mizorisht sa janë marrë fëmijë të vegjël dhe pa menduar fare janë vrrarë dhe janë lënë mbi tokë të pa varrosur”.¹⁷

Ata që morën pjesë në revoltat e periudhës dhjetor 1944 – shkurt 1945 e më pas, nuk ishin kundërrevolucionarë e reaksionarë, por disa dhjetëra mijë atdhetarë, kryesisht të zonave rurale, të cilët kërkonin ndalimin e fushatës së egër të terrorit, zgjidhjen e drejtë të problemit kombëtar duke bërë pyetjen e natyrshme “Ç’duam ne shqiptarët në Jugosllavi?”

Revoltat u shoqëruan me luftime të ashpra e me humbje të rënda për popullsinë, por edhe për repartet jugosllave. Shqiptarët që morën pjesë në këto revolta krijuan zona të lira, sulmuan qytete si Ferizajn, arritën të marrin Gjilanin. Lëvizja u zhvillua me parullën “luftë kundër serbëve, të bashkohemi me Shqipërinë”.¹⁸ Letër nga Mitrovica e komandës së Divizionit V për KQ të PKSH, 21 mars 1945) dhe ne nuk duam “kurrgjë tjetër që është në kundërshtim me programin e LNÇL, por vetëm të respektohen të drejtat tona në virtyt të atij programi”.¹⁹ Shqiptarët në Kosovë e më gjerë donin të dinin përse pas mbarimit të luftës “Kosova duhej të ishte me Jugosllavinë. Përse Shqipëria duhej të mbeste e vogël, kur ajo e kishte nisur luftën më parë se të tjerët dhe vetë u çlirua. Pse thonë pakicat shqiptare që ndodhen në Maqedoni, kurse ne jemi më

¹⁷ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14, Viti (më tej: V.) 1945, Dosja (më tej: D.) 15.

¹⁸ *Po aty*, fl. 33.

¹⁹ Arkivi i Ushtrisë – Tiranë (më tej: AU, sot: Arkivi i Forcave të Armatosura (FA)), F. Shtabi i Përgjithshëm, Sektori i Gjykatës, viti 1944-1945, k. 16, dos. 4, fl. 34.

shumë se maqedonasit. Pse ne të mos vemi me Tiranën, kur na kanë thënë të vetëvendosim. Ja pra, ne këtë duam të jemi me Tiranën”.²⁰

Me vendosjen e administratës ushtarake në Kosovë, më 8 shkurt 1945, komanda jugosllave intensifikoi aksionet në shkallë të gjerë për asgjësimin e kryengritësve të Drenicës. Ajo angazhoi tre divizione dhe një brigadë të posaçme. Luftimet përfundimtare u zhvilluan më 12-22 shkurt.

Gjatë luftimeve në Tërstenik, më 21 shkurt, Shaban Polluzha dhe i biri, Tafa morën plagë të rënda dhe, megjithëse mundën të çanin rrethimin, vdiqën në mbrëmjen e asaj dite në afërsi të Çikatovës.²¹ Pak kohë më vonë me rrëzimin e kullës së Dvoranit dhe me mbarimin e municioneve, qëndresa e kryengritësve të Drenicës, pas një muaji luftimesh të përgjakshme mori fund. Me një vendosmëri të rrallë shqiptarët përballuan edhe luftime frontale duke u shkaktuar divizioneve jugosllave, të mbështetura nga artileria dhe aviacioni, humbje të mëdha.

E tërbuar nga rezistenca e jashtëzakonshme dhe humbjet e pësuar, repartet partizane serbe dhe malazeze masakruan si rrallëherë popullsinë civile, gra, fëmijë e pleq. Gjatë 28 ditëve të luftës u vranë dhe u plagosën 430 luftëtarë nga Drenica, u dogjën e plaçkitën 450 shtëpi, u konfiskua ushqim dhe bagëtitë e 6000 banorëve të rretheve të Vushtrisë e Mitrovicës etj.

Gjatë qëndresës së dhjetorit, janarit dhe shkurtit, rreth 40 mijë shqiptarë u masakruan nga të ashtuquajturit “çlirimtarë” çka do të thotë se u likuidua si kurrë më parë rreth 6% e popullsisë shqiptare në Jugosllavi.²² Dhe kjo i bëhej një popullsie, që po t’u referohemi shifrave zyrtare të publikuara në vitet e RSF Jugosllave të futur në radhët partizane, si vullnetarë ose të rekrutuar rreth 10% të popullsisë ose 16% të meshkujve, 1 në çdo 4 meshkuj në moshë (afërsisht 60.000 partizanë) nga të cilët më shumë se gjysma 32.000 u dërguan të luftonin në veri të Jugosllavisë kundër gjermanëve e çetnikëve.

²⁰ *Po aty*, F. Shtabi i Përgjithshëm, Sektori i Gjykatës, viti 1944-1945, k. 2, dos. 18, fl. 124.

²¹ *AU*, Fondi Brigada e 8-të, viti 1945, kutia 3, dos. 5, fl. 1.

²² Tahir Zajmi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit*, Bruxelles, 1965; shih edhe L. Nasi, *Ripushtimi i Kosovës ...*, f. 182.

Revoltat popullore në Kosovë, ku vendin e parë e zë ajo e Drenicës nën drejtimin e Sh. Polluzhës, shpërthyen dhe u zhvilluan pas mbarimit të luftës. Ato ishin shprehje e kundërshtimit të parë e të hapur të shqiptarëve në ato vise kundër politikës armiqësore që mori përmasat e terrorit të organizuar dhe që synonte asgjësimin fizik e sistematik të shqiptarëve të pambrojtur e të pafajshëm dhe kundër pushtimit të ri. Ato paralajmëruan se problemi kombëtar i shqiptarëve në Jugosllavi nuk mund të mbyllet me dhunë e forcë, kundër logjikës dhe karakterit objektiv të strukturës kombëtare të popullsisë së kësaj treve. Çështja e shqiptarëve dhe e Kosovës do të rihapej në rrethana dhe në një kontekst të ri historik e politik.

